

Instituti për Studime të Avancuara GAP

# Prizreni – Raporti komunal

Tetor 2009

## Prizreni në shifra

<b>Popullsia</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>174300</b>
	Shqiptarë	79.2%
	Boshnjak	12.6%
	Turq	5.1%
	Të tjerë	3.1%
<b>Gjeografia</b>	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	640
	Numri i fshatrave	73
<b>Shkollimi</b>	Pa shkollë/fillore e papërfunduar	17.63%
	Fillore/e mesme e papërfunduar	50.1%
	E mesme	24.45%
	Shkollë e lartë	6.32%
	Universitet	1.50%
	Nr. i nxënësve	39133
	Nr. i mësimdhënësve	2007
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	11
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	70
	Nr. i çerdheve	1
	<b>Shëndetësia</b>	Spital
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare		1
Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore		33
Nr. i mjekëve		128
<b>Papunësia</b>	Gjithsej	35.0%
	Meshkuj	30.65%
	Femra	50.0%
<b>Të punësuar</b>	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	106,323
	Të punësuar në sektorin publik komunal	3,126
<b>Buxheti 2009</b>	Gjithsej (Euro)	22,481,913
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	3,948,500
	Të hyrat tjera (Euro)	18,533,413
<b>Shpenzimet e realizuara (2008)<sup>1</sup></b>	Gjithsej (Euro)	17,785,057 (94%)
	Shpenzimet kapitale (Euro)	5,872,818 (87%)
	Shpenzimet tjera (Euro)	11,912,239 (97%)
<b>Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007</b>	PDK	28.43%
	LDK	24.78%
	AKR	9.54%
	AAK	7.29%
	KDTP	7.06%
	VAKAT	6.55%
	ORA	5.54%
	LDD	3.83%
	PD	2.03%
	SDA	2.00%
	Tjera	2.94%

<sup>1</sup> Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

## Shkurt për Prizrenin

Qyteti i Prizrenit që shtrihet në pjesën jugore të Rrafshit të Dukagjinit. Prizreni zë një sipërfaqe prej 640 km<sup>2</sup>. Duke zënë 5.94 % territorit të Kosovës, Komuna e Prizrenit renditet si e dyta në Kosovë për nga sipërfaqja. Kjo komunë ka 76 vendbanime dhe ka 174.300 banorë nga të cilët në Prizren jetojnë janë rreth 110,000. Për shkak të ngjarjeve që datojnë që nga Lidhja e Prizrenit dhe monumenteve të shumta me karakter kombëtar, Prizreni simbolikisht njihet edhe si kryeqyteti i të gjithë shqiptarëve. Në shekullin XIX Prizreni ishte qendra e dytë më e rëndësishme ekonomiko - tregtare e trojeve shqiptare me rreth 1,500 dyqane. Sot Prizreni është ndër qytetet më të frekuentuara për nga numri i turistëve për shkak të trashëgimisë së shumë objekteve me karakter kulturo-historik sikurse kompleksi i Shadërvanit, Nënkalaja, Marashi, Kalaja, Kisha e Shën Premtës, Xhamia e Bajraklisë, Xhamia e Sinan Pashës, Hamamet e qytetit, krojet e qytetit, ura e gurit dhe një numër i madh i shtëpive folklorike të qytetarëve të trashëguar ndër shekuj.

## Problemet aktuale

Problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohet komuna e Prizrenit janë:

- Uji i pijshëm
- Shkatërrimi i trashëgimisë kulturore
- Mungesa e vend parkingjeve
- Kanalizimet dhe ujërat e zeza
- Mungesa e ciceronit turistik

Mungesa e **ujit të pijshëm** është një ndër problemet më të mëdha me të cilin ballafaqohen për çdo ditë qytetarët e komunës së Prizrenit. Mungesa e ujit është problem jo vetëm për qytetin por edhe për fshatrat e kësaj komune. Por, përderisa nëpër fshatra, sidomos ato të anës së Hasit, banorët ia dalin me anë të puseve, banorët e qytetit varën kryekëput nga ujësjellësi. Fajin për mungesë të ujit qytetarët ia lënë komunës, e në veçanti ujësjellësit të qytetit 'Hidrogjeni Jugor' i cili fajësohet për keq menaxhim. Pjesët më të prekura të qytetit nga ky problem janë ato në periferi. Në lagjen "Arbana" ka shumë pak ujë gjatë ditës, kurse në lagjen "Tusus" reduktimet janë tejet të gjata. Gjendje e mjerueshme për ujë mbizotëron edhe në fshatin Gjonaj të rrethit të Hasit ku nganjëherë me javë nuk rrjedh ujë i pijshëm. Sa i përket burimeve të ujit, qytetarët përmendin burime uji që mund të sillëshin në Prizren me pak përkushtim të komunës. Në fshatin Vermicë, 12 km larg nga Prizreni ata thonë se ekzistojnë dy burime që do të mund të furnizonin një pjesë të madhe të komunës me ujë. Burim tjetër konsiderohet të jetë ai në kodrën e quajtur Cylen, që me anë të rënies së lirë uji mund të silltet deri te akumuluesi i ujit të qytetit. Pastaj në fshatin Poslisht flitet të jetë një burim tjetër që mund të silltet në qytet. Vjetërsia e gypave të sistemit të ujësjellësit jo vetëm që humb sasi uji por është rrezik që ujërat e

zeza të depërtojnë në gypa të tillë. Zgjidhja e ujit të pijshëm për Prizrenin duhet të jetë një nga prioritetet e pushtetit të ardhshëm lokal.

Problemi numër dy me të cilin ballafaqohen qytetarët e kësaj komune është **Shkatërrimi i trashëgimisë kulturore**. Prizreni konsiderohet si qytet i vjetër me monument të lashta të cilat duhet të ruhen. Pjesa e vjetër e qytetit që quhet si Zona I dhe Zona II, mbrohet edhe me ligj. Por viteve të fundit është parë një degradim urban i kësaj zone të mbrojtur, në zemër të së cilës gjendet edhe qendra e qytetit, Shadervani. Dhënia e lejes për ndërtim në këtë zonë duhej të ishte shumë rigorozë, sipas ligjit. Edhe atëherë kur jepet leja, objekti nuk duhet të jetë më i lart se dy kate. Megjithatë, edhe kur dikush merr leje për ndërtim në këto dy zona, pronari shpesh i ik planit dhe ndërton objektin sipas dëshirës. Inspektorët nuk janë duke kryer punën e tyre. Një rast i tillë është një objekt i ri që po ndërtohet në zemër të zonës I, ku është shkatërruar shtypshkronja Ramiz Sadiku dhe tani është duke u ndërtuar një banesë me 6 kate. Te 'Qafa e kishës' në qendër të qytetit është prishë një qeshme e vjetër dhe në vend të saj pronari ka zgjeruar pronën e tij. Një dyqan i vjetër në Shadervan që ishte pronë e një Berberi, një veçori tipike e Prizrenit, është prishë dhe në vend të saj është ndërtuar një shitore moderne. Përball Hamamit është ndërtuar një shitore tre katshe që ia prish imazhin Hamamit shumëvjeçar. Të gjitha këto konsiderohen shkelje e ligjit nga qytetarët, por që megjithatë kanë marrë pëlqimin e organeve kompetente për ndryshime të tilla. Një ankesë tjetër e qytetarëve është edhe ndërtimi i një Billbordi gjigant i cili ndodhet përball Hotel Therandës. Ky billboard ia ka zënë pamjen Xhamisë së Sinan Pashës dhe ndodhet në një vend tejet të pa përshtatshëm. Por pasi se komuna përfiton nga reklamat e shfaqura në të, ky billboard nuk paraqet problem për ta. Një projekt në vazhdim e sipër është edhe renovimi i shtëpisë së mallrave midis Shadervanit. Ky renovim nuk është paraparë në planin urbanistik dhe sigurisht se do t'ia prish imazhin edhe më tepër qytetit. Prizreni është kandidat nga UNESCO për t'u mbrojtur, qytet që duhet të arrij statusin e Gjirokastrës. Problem në të ardhmen do të paraqes edhe Ligji për zonën e mbrojtur të Prizrenit. Ky ligj parashihet edhe me Pakon e Ahtisaarit. Sipas Pakos, zona e I e qytetit të Prizrenit duhet të ketë status të veçantë dhe për aktivitetet në këtë zonë duhet të konsultohet edhe Kisha Ortodokse Serbe. Komunarët deri më tani nuk kanë shfaqur edhe interesimin më të vogël se çfarë do të përmbaj ky ligj, i cili është duke u draftuar, siç thuhet në Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Mund të ndodh që përmbajtja e këtij ligji të cenoj kompetencat e komunës dhe të fuqizoj Kishën Ortodokse Serbe, e cila do të vendos veto për çdo aktivitet në këtë zonë. Por a është në të vërtetë ruajtja e trashëgimisë kulturore në agjendën e partive politike, mbetet të shihet nga programet e tyre për zgjedhjet e Nëntorit.

Një qytet që ka një rritje të dukshme të popullatës dhe një numër turistësh që e vizitojnë vazhdimisht duhet medoemos të ketë më shumë hapësira për parkingje. Prandaj **mungesa e vend parkingjeve** është preokupim tjetër i qytetarëve të kësaj komune. Shpesh ndodh që qytetarët t'i shkojnë rreth e qark qytetit në rrugën një kahëshe në kërkim të një vend parkingu. Një parking që të bie në sy, që është projekt i komunës, është ai përgjatë lumit Bistrica që shtrihet gati deri te 'Lidhja e Prizrenit'. Ky parking, së pari nuk i plotëson gjithë kërkesat e qytetarëve dhe së dyti është në vend të gabuar ngase ajo pjesë më parë është shfrytëzuar si shëtitore nga qytetarët. Pra, është prish një vend relaksues për një vendparking që nuk zë më shumë se 50-60 vettura. Në qytetin e Prizrenit në përgjithësi mund të vërehen investime nëpër rrugë, por vend parkingjet janë lënë anash krejtësisht. Si duket asnjëherë nuk është marrë seriozisht nga kandidatët për kryetar komune zgjidhja e këtij problemi.

**Kanalizimet dhe higjiena.** Nëse shëtit përgjatë lumit Bistrica, mund të vëshesh gypa të mëdhenj që derdhen kanalizimet në lum. Këto ujëra të zeza grumbullohen nga lagje të tëra dhe më pas derdhen në lum. Mungesa e ujit në lum ka bërë që ujërat e zeza të kundërmojnë dhe lëshojnë aromë jo të këndshme për kalimtarët. Kjo i jep një pamje shumë të rëndë qytetit, qendra e të cilit ndodhet mu pranë lumit. Kjo aromë ia zbeh imazhin edhe 'Urës së Gurit' si dhe urave tjera mbi këtë lum që janë atraksion për shumë vizitorët. Kur jemi te kanalizimet, ka edhe fshatra të komunës së Prizrenit që akoma nuk e kanë zgjidhur problemin e kanalizimit. Rast i tillë është ai i fshatit Krajt. Për t'ia prishur edhe më shumë pamjen këtij qyteti janë edhe mbeturinat e hedhura kudo. Komuna nuk pranon të jep përgjegjësi për mos efikasitetin e kompanisë 'Hixhena'. Grumbullimi i mbeturinave në mungesë të kontinjerëve është dukuri e shpeshtë në Prizren. Në rrugën Ersan Mazreku, ka mungesë të kontenjerëve andaj vazhdimisht gjendet një grumbull i madhe mbeturinash. 'Te Kullat' një lagje kjo në periferi të qytetit ka 7 kontenjerë që rrallë pastrohen. Aty kasapët derdhen eshtrat e kafshëve, për se edhe qentë endacak grumbullohen shpesh duke rrezikuar kështu jetën e qytetarëve.

Këtij qyteti turistik i mungon një **ciceronit turistik**. Edhe pse qyteti i Prizrenit njihet për trashëgimi kulturor, qytetit i mungon një qendër për turistët e cila përveç hartës së qytetit do të siguronte edhe ciceronin e qytetit. Me gjithë pikat e shumta turistike që ka qyteti, vizitorët e huaj shpesh duhet t'i gjejnë vet ato pika për t'i eksploruar. E vetmja hartë turistike është ajo e vendosur pranë urës së gurit, që do të thotë se turistit i duhet të shkoj deri aty për t'u orientuar për me tutje. Shenja orientuese mungojnë edhe në hyrje të qytetit.

## **Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës**

Në zgjedhjet e 17 Nëntorit 2007, fitues doli PDK-ja, përderisa besimi për të udhëhequr komunën iu dha Ramadan Mujës. Ramadan Muja (PDK) në raundin e parë mori **15.955 vota** apo **29.13%**, për të shkuar në balotazh ku për kundërshtar kishte kryetarin e deriatëhershëm të Prizrenit, Eqrem Kryeziun nga LDK-ja. Muja arriti të fitoj edhe në raundin e dytë duke marrë **19.890 vota** apo **55%** dhe kështu fitoi të drejtën që në dy vjetët e ardhshëm të udhëheq Komunën e Prizrenit.

Sa i përket premtimeve të dhëna në fushatën parazgjedhore, ka rezultate të pjesërishme. Ndërprerja e kaosit urbanistik, nëse me këtë mund të aludohet në ndërtimin dhe zgjerimin e rrugëve të reja, është realizuar deri diku, pasi se Prizreni tashmë i ka hyrjet e zgjeruara, kurse brenda qytetit është zgjeruar rruga kryesore prej Shtëpisë së Bardh deri te Ben Af-i. Megjithatë, ndërtimet pa leje nuk janë ndërpre, ndërtimet në tokat bujqësore kanë vazhduar, kurse në zonat e mbrojtura ka vazhduar avazi i shkatërrimeve/ndërtimeve të objekteve private, si ato në Shadervan. Monumentet kulturore, me të cilat çmohet ky qytet, nuk janë mbrojtur siç kishte premtuar, kurse asgjë nuk është bërë në ndaljen e ndërtimeve në Prevallë. Ajo me të cilën dallohet kjo qeverisje dhe që mund të konsiderohet edhe si realizim i premtimeve, është rritja e transparencës kundrejt qytetarëve dhe medieve.

Papunësia nuk ka shënuar ndonjë rënie, nuk shihet as ndonjë iniciativë për stimulimin e ekonomisë së vogël, kurse qytetarët bashkë me papunësinë,

ballafaqohen edhe me probleme tjera jetike, siç është uji i pijes, ndotja e lumit, dhe higjiena e qytetit.

Tab.1. Premtimet dhe realizueshmëria e tyre

Premtimet	Realizimi
Do të ndërpritet kaosi urbanistik, do të ndërpritën menjëherë ndërtimet pa leje, do të ndërmerren masa për pengimin e ndërtimeve në tokat bujqësore, do të ndërpritën ndërtimet në zonat e mbrojtura	Premtim i realizuar pjesërisht. Trafiku pritet të lehtësohet me hapjen e rrugës 'Zahir Pajaziti', hyrjet në qytet janë zgjeruar. Megjithatë, ndërtimet pa leje nuk janë ndërpre, midis Shadervanit vazhdojnë rrënimet/ndërtimet e objekteve private, zonë kjo e mbrojtur me ligj.
Do të rritet transparencja në çdo aspekt të qeverisjes komunale, sidomos do të sigurohet transparencë të plotë në zyrën e prokurimit	Premtim i realizuar deri diku, sidomos në raport me mediet. Gazetarët për herë të parë janë lejuar të marrin pjesë në Mbledhjen e Bordit të Drejtorëve si dhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa. Megjithatë, në zyrën e prokurimit mungon transparencja e plotë.
Do të mbrohen monumentet kulturore në qytet si shtëpia e Muserlive, shtëpia e ministrit të qeverisë së Lidhjes së Prizrenit Shaip Spahiu etj.	Premtim i pa realizuar.
Do të luftohet korrupsioni dhe do të punësohen njerëz ekspert dhe të pa korrumpuar	Premtim i realizuar pjesërisht. Punësimi i njerëzve jo adekuat ka vazhduar.
Nuk do të lejohet shkatërrimi i këtij fshati turistik	Premtim i pa realizuar.
Do të zbutet papunësia, duke e stimuluar ekonominë e vogël dhe të mesme	Premtim i pa realizuar.

## Zgjedhjet lokale në Prizren

Në dy mandatet e parë qeverisës, Prizreni është qeverisur nga LDK-ja ku për kryetar komune ishte Eqrem Kryeziu. Në zgjedhjet e vitit 2000, LDK-ja kishte fituar bindshëm ndaj partisë së dytë më të madhe, asaj të PDK-së. LDK-ja me 36,196 vota fitoi 24 ulëse në KK, kurse PDK-ja ishte në opozitë me vetëm 10 ulëse në KK në bazë të 15,406 votave sa kishte fituar. Kryetar i komunës u përzgjedh Eqrem Kryeziu. Edhe në zgjedhjet e vitit 2002 LDK-ja doli fitues ndaj rivalit më të madh, PDK-së. Meqë në këto zgjedhje bëhej fjalë për një mandat 5 vjeçar, më shumë parti morën pjesë në zgjedhje. Prandaj, LDK-ja edhe pse doli subjekt i fitues i zgjedhjeve, në këtë fushat regjistroi një rënie në vota prej afër 12,000 sosh, kurse PDK-ja pati një rritje prej rreth 2,000 votave, gjithnjë krahasuar me zgjedhjet e vitit 2000. Numri më i madh i ulëseve në KK përsëri i takoi LDK-së me 16 sosh, PDK-së 12, KDTP 4, e kështu me radhë. Zgjedhjet e vitit 2007 sollën një skenar krejt tjetër. Pas shatë viteve në pushtet, kryetari i LDK-së në këtë komunë, Eqrem Kryeziu i humbi zgjedhjet karshi Ramadan Mujës nga PDK-ja. Në raundin e parë Ramadan Muja morri **29.13%** të votave, kurse pas balotazhit ai fitoi **55 %** votave. Nga 41 vende në Kuvendin Komunal, 12 ulëse i takojnë PDK-së kurse 10 deputetëve të LDK-së. LDD-ja e cila për herë të parë garoi në këto zgjedhje fitoi 2 ulëse, që do të thotë se ndarja e LDK-së në dy subjekte

politike, mund të jetë një shkaktar që LDK-ja të humb dominimin e saj prej 7 vjetësh në këtë komunë.

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Prizrenit.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	15406	10	17947	12	15118	12
LDK	36196	24	24138	16	13175	10
AAK	2314	2	3129	2	3874	3
KDTP	-	-	6265	4	3756	3
PD	-	-	1200	1	1078	1
LDD	-	-	-	-	2035	2
AKR	-	-	-	-	5070	4
ORA	-	-	-	-	2946	1
SDA	-	-	-	-	1064	1
VAKAT	-	-	-	-	3484	3
PSHDK	907	1	-	-	-	-
PNDSH	792	1	-	-	-	-
DRSM	1769	1	-	-	-	-
BSDAK	2967	2	950	1	-	-
VATAN	-	-	3200	2	-	-
PSHDK	-	-	918	1	-	-
“Povratak”	-	-	1745	1	-	-
DPP	-	-	1501	1	-	-

Edhe numri i votuesve ka shkuar duke rënë gjithnjë në tri palë zgjedhjet lokale. Përderisa në zgjedhjet e para lokale dalja e votuesve në zgjedhje ishte rreth 78.6%, dy vjet më vonë ajo ra në 55.3%, kurse për vitin 2007 mungojnë të dhënat, megjithatë besojmë se ky trend ka vazhduar të bie edhe më tej. Në zgjedhjet e ardhshme të 15 Nëntorit 2009 të drejtë vote kanë 137,764 qytetarë.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Prizren në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

	2000	2002	2007
Votues me të drejtë vote	85371	117347	?
Pjesëmarrja në votime	67102	64948	53169
Përqindja e daljes në votime	78.6%	55.35%	?%

## Buxheti i Komunës

Buxheti i Komunës së Prizrenit ka shënuar një rritje të vazhdueshme. Nëse krahasohet buxheti i vitit 2003 me atë të vitit 2009, mund të dallojmë një rritje prej më se 8 milion euro. Megjithatë ka pasur luhatje të buxhetit brenda 6 viteve të kaluar. Përderisa gjatë vitit 2004-2005 buxheti i komunës ishte mbi 17 milion euro, në vitin 2006 ai pësoi rënie në rreth 16 milion euro, për të rënë edhe më tepër, në 15 milion gjatë vitit 2007. Rritja më e madhe e buxhetit ndodhi në vitin 2009 që krahasim me vitin 2008, buxheti u rrit për 5,401,493 euro. Pjesa më e madhe e buxhetit vjetor 2009, është shpenzuar për investime kapitale, gjithsej 9,852,878 euro, që është rreth 4 milion euro më shumë se në vitin paraprak.

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Rezervat	Gjithsej
2009	€9,627,454	€2,073,762	€612,319	€315,500	€9,852,878	-	€22,481,913
2008	€8,034,231	€2,429,180	€659,841	€315,500	€5,641,668	-	€17,080,420
2007	€7,816,285	€1,913,254	€991,682	€292,079	€4,639,552	-	€15,652,852
2006	€7,714,092	€1,896,335	€968,341	€299,904	€5,318,177	-	€16,196,849
2005	€7,451,557	€1,627,596	€284,300	€87,500	€7,691,889	-	€17,142,842
2004	€7,116,081	€2,791,043	-	-	€7,403,097	€277,162	€17,587,383
2003	€5,525,503	€3,746,554	-	-	€4,555,981	€225,976	€14,054,014

Nga tabela e më sipërme mund të vërejmë se kryesisht ka pas një rritje konstante në shpenzimet për rroga dhe mëditjet, gjegjësisht 9,627,454 euro të buxhetit total. Krahasuar me vitin 2008, më 2009 për rroga dhe mëditje janë shpenzuar afër 1,600,000 euro më tepër.

## Investimet kapitale

Nëse merret një mesatare për vitet 2003-2008, mund të themi se komuna e Prizreni ka pas një buxhet mes 5 – 6 milion euro për investime kapitale në vit. Gjatë dy viteve të fundit janë kryer shumë projekte kapitale, disa prej të cilave i kemi pasqyruar në tabelen më poshtë.

Tab.5.: Investimet kapitale në Prizren gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Ndërtimi i rrugës Gjonaj-Mazrek	€130,000
2008	Ndërtimi i rrugës Krushë e vogël-Randobravë	€150,000
2008	Ndërtimi i rrugës Benaf-Arbanë	€258,963
2008	Ndërtimi i shkollës Luigj Gurakuqi	€182,641
2008	Ndërtimi i kanalizimit në rrugën Lasgush Poradeci	€193,726
2009	Ndërtimi i rrugës Enti për punësim-Benaf	€800,000
2009	Ndërtimi i rrugës Jusuf Gërvalla	€120,000
2009	Ndërtimi i QMF-së 11 Marsi Petr.	€100,000
2009	Ndërtimi i Art Qendrës	€250,000



Shpenzimet në investime kapitale në tri vitet e ardhshme janë paraparë të rriten edhe më tej. Kuvendi Komunal i Prizrenit veç ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2010-2012. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, komuna e Prizrenit do të ketë në dispozicion 38,737,043 € për investime kapitale, gjegjësisht 12,379,793 euro për 2010, 12,815,118 euro për 2011, dhe 13,542,132 për vitin 2012.

Tab.6.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Prizren 2010-2012

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	25,649,755	26,408,502	27,365,242
Të hyrat vetanake në €	4,964,235	5,121,830	5,269,575
Investimet kapitale në €	12,379,793	12,815,118	13,542,132

Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Prizrenit për mandatin e tij qeverisës katërvjeçar do të ketë në dispozicion pak më shumë se 50 milion € për investime kapitale.

## Administrata komunale

Në sektorin publik në komunën e Prizrenit në vitin 2009 janë të punësuar 3,126 veta. Këta persona janë të punësuar në sektorin e arsimit, shëndetësisë dhe administratës. Krahasuar me vitin 2008, sektori publik i kësaj komune është rritur për 21 persona. Sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.10/46 (3 dhjetor 2008), komuna e Prizrenit ka mungesë të shërbyesve civil, sipas përlllogaritjes një pozitë për 750 banorë. Prandaj, sipas këtij vendimi komuna e Prizrenit duhet të shtoj numrin e stafit komunal edhe për 71 persona.

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Prizrenit sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	3126 ▲
2008	3105 ▲
2007	3075 ▼
2006	3164 ▲
2005	3148 ▲
2004	3138 ▲
2003	2865 ■

## Komuna e Prizrenit dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Sa i përket përmbushjes së obligimeve që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, gjegjësisht numrin të mbledhje që duhet t'i mbaj kuvendi komunal gjatë një viti, Prizreni qëndron kryesisht mirë. Gjatë vitit 2008, KK ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje, nga 10 sosh sa është i obliguar të mbahen sipas ligjit. Ndërkaq, Komiteti për Politikë dhe Financa, është takuar gjithsej 9 herë.

Ndërsa sa i përket tubimeve publike që komuna ka mbajtur me qytetarët, Prizreni gjatë vitit 2008 ka mbajtur 7 tubime publike, kurse deri më tani në vitit 2009 janë mbajtur 5 tubime publike. Edhe pse qytetarët njoftohen të paktën 7 ditë më herët për mbajtjen e tyre, kryesisht përmes tri televizioneve lokale dhe posterave, pjesëmarrja e qytetarëve është tejet e vogël.

Gjatë vitit 2008 ka pasur gjithsej 7 kërkesa për qasje në dokumentët zyrtarë, kurse gjatë vitit 2009 ka pasur 5 kërkesa të tilla dhe se të gjitha kanë marrë përgjigje. Gjatë dy viteve të kësaj qeverisje nuk ka pasur asnjë peticion në adresë të komunës.

Ueb faqja ka një strukturë organizative mjaftë të qartë. Është e mirëmbajtur në baza të rregullta kohore. Është e pajisur me informacione të shkëlqyeshme aq sa një qytetari të Prizrenit do t'i nevojiteshin rreth aktiviteteve të komunës dhe më gjerë. Ballina ka strukturën e duhur të një ueb faqeje zyrtare që i përshtatet Prizrenit si qytet i vjetër.

Tab.8. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Prizrenit ([www.komuna-prizreni.org](http://www.komuna-prizreni.org))

Kategoritë e informacioneve	Niveli i informatave <sup>2</sup>
<b>Ballina</b>	5
<b>Organizimi komunal</b>	5
<b>Shërbimet komunale</b>	3.6
<b>Info rreth qytetit</b>	3.25
<b>Projektet komunale</b>	2.5
<b>Lajme &amp; lajmërim</b>	4
<b>Harta e faqes</b>	3
<b>Kontakt</b>	5
<b>Gjuhët</b>	3
<b>Fusha për kërkim</b>	5
<b>Tjera informacione shtesë</b>	2
<b>Baza Ligjore</b>	4
<b>Mesatarja totale</b>	<b>3.78</b>
<b>Renditja në krahasim me ueb faqet e komunave tjera</b>	<b>3</b>

## Gjendja në arsim

Komuna e Prizrenit ka 39,133 nxënës dhe 2,007 mësime dhënë. Numri i përgjithshëm i punëtorëve të arsimit është 2,350, që do të thotë se kjo komunë për 100 banorë ka 1.3 punonjës të arsimit. Në komunën e Prizrenit funksionojnë 5 shkolla të mesme (pa i numëruar paralelet) dhe 43 shkolla fillore amë me 33 paralele të ndara. Për dallim nga komunat tjera, procesi mësimor në komunën e Prizrenit zhvillohet në tri gjuhë: shqipe, boshnjake, turke. Edhe pse gjatë dy viteve të fundit janë bërë investime të shumta në ndërtimin e shkollave fillore, sikurse shkolla e re e ndërtuar në lagjen 'Ortakoll', në lagjen 'Bajram Curri' etj, edhe më tej mbetet shqetësuese praktika e

<sup>2</sup> (rradhitja nga 1 deri 5) 5 - shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

emërimit të drejtorëve të shkollave në baza partiake. Edhe kjo qeveri lokale, nuk ka mund t'i ikë nepotizmit, sidomos kur vjen në shprehje transferimi i mësuesve nga një shkollë në tjetrën. Bojkotimi i mësimit për javë të tëra nga nxënësit e klasës II-3 të shkollës 'Mati Logoreci' ka qenë një skandal që vërtetoi këtë dukuri. Shqetësuese në shkollat e Prizrenit mbetet edhe dukuria e huliganizmit, ku nuk kursehen edhe vetë drejtorët e shkollave, sikurse ai i shkollës 'Lekë Dukagjini', të cilit i dëmtohet vetura në oborr të shkollës nga nxënësit e tij.

## Gjendja në shëndetësi

Komuna e Prizrenit përveç spitalit rajonal që ka, dhe Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), ka edhe 33 QMF dhe punkte shëndetësore. Në total kjo komunë ka 128 mjekë, apo 475 punëtorë shëndetësor që do të thotë 2.7 punëtorë shëndetësor për 1,000 banorë, përqindje kjo e cila mund të konsiderohet jo e kënaqshme krahasuar me qytetet tjera si Prishtina (3.5 punëtorë) apo Gjakova (3.0 punëtor shëndetësor). Në këtë komunë, është për tu përshëndetur kujdesi i organeve shëndetësore për vaksinimin e vazhdueshëm të fëmijëve, ku vetëm gjatë vitit 2008, janë realizuar 90% e të planifikuarve për vaksionim.

## Shoqëria civile

Shoqëria civile në këtë komunë gëzon një reputacion për aktivitete e tyre, edhe pse jo të gjithë OJQ-të kanë për synim monitorimin e punës së Qeverisjes Lokale. Shoqëria civile ende nuk monitoron vazhdimisht punën e qeverisë lokale, si duket për shkak të presioneve nga politika. Më e zëshmjia organizatë në mesin e tyre është Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) e cila shpesh ka monitoruar dhe kritikuar punën e qeverisjes lokale. Një nga publikimet e këtij instituti është edhe fletënotimi i anëtarëve të Kuvendit Komunal. Kësisoj, ky Institut bën një analizë të punës dhe angazhimit të secilit anëtarë të kuvendit, angazhim ky i cili notohet nga ky Institut.

## Mediat lokale

Qyteti i Prizrenit ka katër televizione lokale dhe disa radio. Për shkak të numrit të madh të medieve lokale, qytetarët e kësaj komune janë të informuar në forma të ndryshme me proceset në komunë. TV Opinion është i vetmi TV lokal që transmeton mbledhjet e Kuvendit Komunal, falë një kontrate që ky medium ka me Kuvendin Komunal. Bindja e qytetarëve qëndron se mediumet japin një pasqyrë më shumë promovuese për pushtetin lokal, se sa monitoruese apo mbulim të të gjitha ngjarjeve. Partitë politike mundohen që të ndikojnë në politikën redaktoriale të këtyre medimeve, sidomos të televizioneve lokale. Në përgjithësi, medimeve lokale u mungon profesionalizmi i duhur, sidomos në raportimin e ngjarjeve nga jeta publike komunale.

## Rendi dhe ligji në Komunën e Prizrenit

Nga 1 janari 2008 deri 31 dhjetor 2008, në Komunën e Prizrenit kanë ndodhur **3902** raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, në gjithsejtë **73 shkelje të natyrave të ndryshme**. Shkeljet më të mëdha kanë ndodhur në këto fusha:

Tab.9. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Prizren (2008)

Natyrë e shkeljes së rendit dhe ligjit	Numri i rasteve të shënuara	Renditja në krahasim me komunitat tjera për numrin e rasteve të ndodhura
Aksidente	492	
Prishja e rendit dhe qetësisë publike	103	
Pengim i personave zyrtar në kryerjen e punës	97	
Vjedhje e pyjeve	1	
Incidente lidhur me pronën	449	
Vjedhje	1236	
Abuzime seksuale	12	
Shkaktim të dëmtimeve trupore	461	
Kërcënime	336	
Mashtrime	66	
Vrasje	14	
Incidente në baza etnike, religjioze apo racore	-	

Komuna e Prizrenit është komuna numër dy sa i përket madhësisë së popullatës. Në krahasim me komunitat tjera, Prizreni renditet si i 11 sa i përket prishjes së rendit dhe qetësisë publike, që tregon se kjo komunë është relativisht e qetë. Por, ajo që është shqetësuese në këtë komunë është pengimi i personave zyrtar në kryerjen e punës, që e rendit Prizrenin në vendin e parë për nga numri i rasteve (97 raste). Prizreni gjithashtu renditet i pari sa i përket incidenteve lidhur me pronën, me gjithsej 449 raste, statistikë kjo shqetësuese gjithashtu. Një statistikë pozitive që i përket Prizrenit është numri i vogël i vjedhjes së pyjeve (vetëm një rast).

## Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përlogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifatat tatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05 % dhe 1 % të vlerës së pronës në treg. Tarifatat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore. Tabela më poshtë paraqet llojet e pronës, normat tatimore dhe çmimet e tregut për atë pronë.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Prizrenit

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
	<b>Norma tatimore</b>				
	0.078%	0.078%	0.108%	0.096%	0.06%
<b>I</b>	350	350	2100	420	175

II	320	320	1440	420	160
III	270	270	1080	495	135
IV	250	250	800	495	125
V	200	200	400	250	100
VI	120	120	250	170	60

\* Vlera e tregut për metër katror.

## Kostoja për biznese

Në bazë të rregullores së Komunës së Prizrenit për taksa, ngarkesa dhe gjoha, komuna ka paraparë nivelin e pagesës për funksionimin e çdo lloji të biznesit në këtë komunë. Më poshtë mund të shihni taksat vjetore për disa nga bizneset më të zakonshme në komunën e Prizrenit:

Tab.11. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	800 €
Kompanitë e sigurimit	800 €
PTK komunikimi dhe distribucioni	800 €
Arsimi universitar	800 €
Veprimtaritë e spitaleve	800 €
Shtypshkronjat	320 €
Autoshkollat	240 €
Kafeteritë	120 €
Restorantet	200 €
Hotelet	400 €
Motelet	160 €
Barnatoret	160 - 400 €
Depot	240 €
Kompanitë e transportit të brendshëm - Auto-taksi	320 €
Gurthyesit	400 €
Punëtoritë (argjendaritë, zdrukthëtaritë, automekanikët, bukëpjekësit, floktar, etj.)	40 - 80 €
Pompat e benzinës	800 €
Ndërmarrjet prodhuese	400 €
Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.)	240 - 320 €